

## **EYE – Rritja e Punësimit për të Rinj**

### **Kërkesë për Propozim (KPP)**

### **Nr. 12/2018\_EYE\_Output 1.1**

**Titulli i KPP-së: Zhvillimi i 15 (pesëmbëdhjetë) standardeve të profesionit**

Data e hapjes për aplikim: 5.11.2018

Data e mbylljes për aplikim: 19.11.2018

Projekti Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE)  
Mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)  
Implementuar nga konsorciumi Helvetas Swiss Intercooperation dhe MDA

Nazim Gafurri 33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
+381 (0) 38 517 715  
[www.eye-kosovo.org](http://www.eye-kosovo.org)

## PJESA E PARË UDHËZIME PËR OFERTUESIT

### I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

- A. Dhënja e një nënkontratë për të siguruar shërbime në lidhje me këtë Kërkesë për Propozim (KPP) është subjekt i fondeve që janë në dispozicion.
- B. Projekti EYE rezervon të drejtën për të refuzuar secilin propozim apo të gjitha propozimet. Nuk ekziston asnjë detyrim i shprehur apo imponuar nga ana e kontraktorit (EYE) për të ofruar ndonjë shpërblim për punën apo koston e shkaktuar për përgatitjen e propozimit si përgjigje ndaj kësaj Kërkesë për Propozime.
- C. Propozimi duhet të dorëzohet në përputhje me udhëzimet e përcaktuara më poshtë. Ofertuesi duhet të paraqesë propozimin në një (1) ekzemplar origjinal, të shënuar në mënyrë të qartë si 'Origjinali', 3 kopje, secila e shënuar si 'Kopje', në një zarf të mbyllur të shënuar si në vijim:

#### **KPP Nr. 12/2018\_EYE\_Output 1.1**

- D. Të gjitha propozimet e pranuar si përgjigje ndaj KPP-së do të jenë pronë e projektit EYE dhe nuk do të kthehen mbrapsht.
- E. Pyetjet në lidhje me këtë Kërkesë për Propozim mund të bëhen përmes emailit [kosovo.info@helvetas.org](mailto:kosovo.info@helvetas.org) deri më 7 nëntor 2018 në ora 16:00, ndërsa përgjigjet do të jepen më së voni deri më 8 nëntor 2018, në ora 16:00. Asnjë pyetje në lidhje me këtë KPP nuk do të merret parasysh pas datës së përcaktuar.

### II. ORARI

- A. Propozimi i ofertës duhet të dorëzohet tek EYE jo më vonë se me datën 19.11.2018, ora 16:00, në adresën e mëposhtme

Personi kontaktues: znj. Elheme Xheladini  
HELVETAS Swiss Intercooperation - Kosovo  
Str: Nazim Gafurri 33, P.O. Box 2  
10000, Prishtinë

- B. EYE parashikon që puna të fillojë më 23.11.2018 dhe të përfundojë në periudhën e përcaktuar në TeR.

### III. E DREJTA PËR T'U ZGJEDHUR

Pjesëmarrja në këtë KPP është e hapur për gjithë konsulentët dhe kompanitë e konsulencës në Kosovë që kanë përvojë përkatëse për detyrat e përcaktuara në TeR.

## V. NDALESA E BASHKËPUNIMIT ME PALËT E TRETA

Çdo ofertë e pranuar nga ofertuesit që përfshijnë personat e ndryshëm juridik, ndryshe nga ata të përmendur në formularët e aplikimit, do të përjashtohen nga kjo procedurë e tenderimit. Ofertuesit mund të krijojnë lidhje bashkëpunimi ligjërish të verifikuar.

## VI. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Ofertuesi duhet të ketë parasysh se ka vetëm një mundësi për të dorëzuar një Propozim si përgjigje ndaj kësaj KPP-je. Prandaj, kërkohet vëmendje e kujdesshme për t'u siguruar që të gjitha dokumentacionet teknike dhe informacionet tjera të domosdoshme të jenë të përfshira për të mbështetur Propozimin.

Niveli i prapaveprimit ndaj detajeve si dhe cilësia dhe qartësia e përgjithshme e këtij propozimi do të konsiderohet nga EYE si një tregues i cilësisë së punës që ofertuesi ka gjasa të ofrojë gjatë zbatimit të projektit, në rast se zgjedhet si fitues.

Vlerësimi do të rezultojë me vendimin se Propozimi i Ofertuesit është i pranueshëm ose i papranueshëm. Nëse Propozimi përcaktohet si i papranueshëm, oferta nuk do të merret më në konsideratë.

Propozimet do të vlerësohen sipas kriterëve në vijim:

Kriteri	Pikët maksimale
<i>Propozimi teknik</i>	<b>40%</b>
<i>Ekipi i propozuar</i>	<b>40%</b>
<i>Oferta financiare</i>	<b>20%</b>
<i>Gjithsej pikë maksimale</i>	<b>100%</b>

Pas vlerësimit paraprak të ofertave, EYE rezervon të drejtën që të diskutojë/sqarojë me ofertuesit e parazgjedhur për të ndryshuar dhe/ose përfunduar ofertat e tyre fillestare.

Kontrata do t'i jepet ofertës më të favorshme dhe propozimit më cilësor. EYE rezervon të drejtën që të anulojë këtë procedurë të KPP-së nëse nuk është e kënaqur me cilësinë e propozimeve.

## VII. NDRYSHIMI OSE TËRHEQJA E APLIKACIONIT

Ofertuesit mund ta ndryshojnë ose tërheqin aplikacionin e tyre përmes njoftimit me shkrim para afatit të dorëzimit të propozimeve. Pas këtij afati nuk do të merret parasysh asnjë ndryshim.

Pjesa e jashtme e zarfit (dhe zarfi përkatës i brendshëm) duhet të shënohet me 'Ndryshim' ose 'Tërheqje', sipas përshtatshmërisë.

EYE ka të drejtën të mbajë në pronësi të gjitha propozimet të cilat nuk janë tërhequr. Si rezultat i kësaj, ofertuesit nuk kanë të drejtë të kërkojnë që propozimet e tyre t'iu kthehen mbrapsht.

## VIII. KLAUZOLAT E ETIKËS/ PRAKTIKAT KORRUPTIVE

Ofertuesit që janë fajtor për dhënien e deklaratave të pavërteta mund t'iu nënshtrohen gjobave financiare që përfshijnë 10% të vlerës totale të shumës së pjesës (pjesëve) për të cilën aplikojnë dhe/ose për kontratën që u jepet. Kjo normë mund të rritet deri në 20% në rast se vepra përsëritet.

Çdo përpjekje nga ofertuesi për të siguruar informacione sekrete, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentët apo për të ndikuar në Komisionin e Vlerësimit ose në subjektin EYE gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, do të çojë në refuzimin e ofertës (ofertave) së tij dhe mund të rezultojë në gjobat e përshkruara më lartë.

Ofertuesit nuk duhet të ndikohen nga ndonjë konflikt i interesit me ofertuesit tjerë ose palët e përfshira në projekt. EYE rezervon të drejtën për të pezulluar ose anuluar procedurën e tenderit dhe/ose kontratën nëse zbulon çfarëdo lloji të praktikave korruptive në cilëndo fazë të procesit të dhënjes së kontratës ose gjatë ekzekutimit të saj.

Ofertuesit do të refuzohen ose kontratat e tyre do të ndërpriten nëse konstatohet se dhënja e kontratës ose ekzekutimi i saj ka krijuar shpenzime të pazakonta komerciale. Shpenzimet e tilla të jashtëzakonshme komerciale janë komisionet që nuk përmenden në kontratën kryesore ose që nuk janë si rezultat i një kontratë të lidhur në mënyrë të duhur duke iu referuar kontratës kryesore, komisionet e paguara si rezultat i ndonjë shërbimi aktual dhe të ligjshëm, komisionet e paguara për obligimet tatimore, komisionet e paguara për një përfitues i cili nuk është i identifikuar në mënyrë të qartë ose shpenzimet e paguara për një kompani që gjithmonë është paraqitur si kompani kryesore.

Kontratrat e kontraktuesve për të cilët konstatohet se janë përgjegjës për shpenzime të pazakonta komerciale në lidhje me këtë projekt, varësisht prej seriozitetit të fakteve të hetuara, do të ndërpriten dhe/ose të penalizohen.

EYE rezervon të drejtën të pezullojë ose të anulojë procedurën, nëse procedura e dhënies së kontratës vërteton se ka qenë subjekt i gabimeve, parregullsive ose mashtrimeve të konsiderueshme. Nëse pas dhënies së kontratës zbulohen gabime, parregullsi ose mashtrime të konsiderueshme, HSI-K mund të refuzojë lidhjen e kontratës.

## PJESA E DYTË FORMULARI I DORËZIMIT TË PROPOZIMIT

### I. GJUHA

Propozimet e ofertuesve duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe. Të gjitha raportet dhe dokumentacioni në kuadër të nënkontratës duhet të jenë në gjuhën shqipe.

### II. INFORMATAT E KËRKUARA NGA PROPOZIMET

Propozimet e ofertuesve duhet të përfshijnë së paku këto informacione:

#### Informatat themelore për konsulent:

- Emri i konsulentëve:
- Adresa zyrtare:
- Informatat kontaktuese (Telefoni, faksi, e-maili)
- Personi kontaktues:

#### Informatat themelore për kompani konsulentësh:

- Emri ligjor i organizatës:
- Adresa zyrtare:
- Informata kontaktuese (Telefoni, Faksi, E-maili)
- Personi kontaktues:
- Statusi ligjor i organizatës: *(Ju lutemi dorëzojeni një kopje të dokumentit të regjistrimit së bashku me propozimin):*
- Data dhe numri i regjistrimit:
- Informacioni rreth numrit fiskal/numrit të TVSH-së:
- Certifikatë nga autoriteti tatimor se personi juridik nuk ka obligime
- Kopjen e statutit ose dokumentit të inkomporimit që dëshmon pronësinë kosovare të kompanisë

#### Propozimi teknik

- Plani i implementimit me planifikim të detajuar kohor;
- Metodologjia e aplikuar për zhvillimin e realizimit (DACUM ose analiza funksionale);
- Përshkrimi i aktiviteteve për secilën detyrë; ofrimi i informacioneve si në vijim:
  - Përshkrimi i detyrës (përfshirë datat e fillimit dhe përfundimit);
  - Metoda e implementimit (diskutimet e paneleve përmes punëtorive ose intervistave të drejtpërdrejta);
  - Numri i punëtorive të kryera për secilin standard të zhvilluar profesional dhe kohëzgjatja e tyre;
  - Numri i ekspertëve profesional të përfshirë në zhvillimin e procesit për secilin standard profesional;
  - Personeli përgjegjës për secilën detyrë;
  - Përfshirja e palëve të interesuara, nëse janë të përfshira



## Personeli i propozuar

- Konsulentët – CV-të e tyre
- Sfondi profesional në sektorin e AAP;
- Përvojë 3 vjeçare në implementimin e aktiviteteve të ngjashme;
- Tri referenca profesionale të kualifikuara që duhet të jenë të pavarura

## Oferta financiare

Ofertuesit duhet të dorëzojnë një ofertë financiare origjinale të nënshkruar së bashku me tri kopje ku duhet të përfshihet:

- Buxheti i kompletuar duke përfshirë koston direkte dhe indirekte të mbështetur me shënime buxhetore
- Oferta financiare duhet të paraqitet në euro

Çmimi i propozuar në këtë ofertë duhet t'i përfshijë të gjitha kostot; EYE është e liruar nga TVSH-ja, kështu që kostoja duhet të jetë pa TVSH. Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrat e tjera në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

**Termit e Referencës (TeR)**  
**Zhvillimi i 15 (pesëmbëdhjetë) standardeve të profesionit**  
**Nëntor 2018**

---

## 1. Hyrje

Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE) është një program i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë dhe implementuar nga konsorciumi i HELVETAS Swiss Intercooperation Kosovo (HSIK) dhe Bashkëpunëtorët për Menaxhim dhe Zhvillim (MDA). Qëllimi i përgjithshëm i EYE është t'i përmirësojë kushtet e tregut të punës në Kosovë duke i rritur mundësitë e punësimit për kosovarët e rinj që diplomojnë nga shkollat e AAP dhe universitetet dhe duke facilituar tranzicionin e tyre nga shkolla në punë. Një ndër objektivat kryesorë të projektit EYE është facilitimi i përshtatjes së programeve shkollore me kërkesat e tregut të punës.

## 2. Historiku

Që nga fillimi i vitit 2018, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është duke u ballafaquar me dy sfida shumë të rëndësishme/vendimtare. Një prej sfidave është rishikimi i kurrikulës së profileve të kualifikimit të AAP në mënyrë që kurrikulat të fillojnë së implementuari sa më shpejtë të jetë e mundur nëpër shkollat e AAP. Sa i përket sfidës tjetër, MASHT duhet të dëshmojë për një progres në procesin e akreditimit të shkollave publike të AAP. Që të dyja proceset mbështeten mbi standardet e profesionit, e që aktualisht janë shumë pak të listuara në AKK. Për shkak të kësaj situate, projekti EYE është kontaktuar nga Ministria e Arsimit me ç'rast i është kërkuar mbështetja për zhvillimin e 15 standardeve të profesionit shtesë.

Si rrjedhojë, EYE i bënë thirrje konsulentëve dhe kompanive konsulente të interesuara, që të aplikojnë për zhvillimin e 15 standardeve të profesionit të cilat janë të ndara në tri grupe. Aplikimi mund të bëhet për të trija grupet ose për një grup të veçuar të paraqitura në vijim:

### Grupi 1:

- 7131 Punëtorët për ngjyrosje dhe punëtorët e ngjashëm
- 7122 Shtruesit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave
- 7111 Ndërtuesit e shtëpive
- 7123 Suvatuesit
- 7119 Punëtorët e kornizave të ndërtimit

### Grupi 2:

- 3432 Dizajnerët dhe dekoratorët e interierit
- 7318 Punëtorët e zejës me tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashme
- 7534 Prodhuesit e sfungjerëve dhe të ngjashëm
- 3212 Teknikët e laboratorit mjekësor dhe patologjik
- 3142 Teknikët e hortikulturës

### Grupi 3:

- 7127 Mekanikët për kondicioner dhe pajisje ftohëse
- 3131 Punëtorët e impiantit për gjenerimin e energjisë
- 3511 Teknikët e operimit me teknologjinë e informimit dhe komunikimit
- 4322 Nëpunësit për prodhim
- 3522 Teknikët e inxhinierisë së telekomunikimit

### 3. Objektivat dhe detyrat

Objektivat e kësaj konsulence janë zhvillimi i 15 standardeve të profesionit që do t'i shërbejnë MASHT-it si bazë për të rishikuar kurrikulat e profileve të kualifikimit të AAP. Standardet e profesionit duhet të dorezohen në gjuhën shqipe.

Konsulentët që do të udhëheqin procesin e zhvillimit të standardit të profesionit duhet të jenë ekspertë të procesit e jo ekspertë të përmbajtjeve. Përmbajtja duhet të nxirret nga ekspertët profesional që kanë së paku 4 vite përvojë pune në profesionin përkatës. Në rradhë të parë, ata duhet t'i referohen përmbajtjes së standardeve ndërkombëtare të profesionit për profesionet përkatëse dhe më pastaj t'i verifikojne ato përmes zbatimit/aplikimit të shablloneve dhe metodologjive për zhvillimin e standardeve të profesionit nga AKK (DACUM ose analiza funksionale).

Për t'i realizuar objektivat e lartëpërmendura, kontraktori duhet t'i kryejë këto detyra kryesore:

- Zhvillimi i planit të implementimit me planifikim të detajuar kohor, duke përfshirë:
  - Përshkrimin e detyrës (përfshirë datat e fillimit dhe përfundimit për secilën detyrë)
  - Metodën e punës (diskutimet e paneleve përmes punëtorive ose intervistave të drejtpërdrejta);
  - Numrin e punëtorive të kryera për secilin standard të zhvilluar profesional dhe kohëzgjatjen e tyre;
  - Numrin e ekspertëve profesional të përfshirë në zhvillimin e procesit për secilin standard profesional;
  - Personelin përgjegjës për secilën detyrë;
  - Palët e interesuara, nëse janë të përfshira;
- Përcaktimi i metodologjisë që do të aplikohet (DACUM ose analiza funksionale)
- Identifikimi i ekspertëve profesional për secilin profesion me përvojë pune në profesionin përkatës. Numri i ekspertëve profesional për secilin profesion duhet të jetë nga 6-8;
- Organizimi dhe zhvillimi i punëtorive me ekspertët profesional;
- Integrimi i informatave të grumbulluara nga ekspertët profesional në shabllonin e miratuar nga AKK për standardin profesional;
- Paraqitja e standardeve të profesionit tek EYE për informata kthyesë;
- Përfshirja e komenteve të pranuar;
- Dorëzimi i standardeve përfundimtare të profesionit;



### 3. Rezultatet e pritura

Rezultatet e poshtëshënuara duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe:

- A. Plani i implementimit me planifikimin e detajuar kohor dhe personin përgjegjës;
- B. Dorëzimi i draftit të standardeve të profesionit;
- C. Përfshirja e informatave kthyes nga EYE në draftin e standardeve të profesionit;
- D. Dorëzimi i standardeve përfundimtare të profesionit;<sup>1</sup>

### 4. Korniza kohore

Detyrat e caktuara duhet të kryhen brenda një periudhë të cekur mëposhtë duke filluar sa më shpejtë të jetë e mundur.

Komponentët	Datat
Thirrja e hapur për propozim	5.11.2018
Afati i fundit për dorëzimin e propozimit	19.11.2018
Përcaktimi i propozimit	20.11.2018
Fillimi i zbatimit të detyrave	23.11.2018
Dorëzimi i standardeve të profesionit	28.02.2019

### 4. Oferta financiare

Kontrata do të jetë kontratë me çmim fiks. Buxheti maksimal i vënë në dispozicion për implementimin e detyrave të përcaktuara nga TeR është maksimum 2,500.00 euro për një standard të profesionit /37,500.00 euro për 15 standarde të profesionit pa përfshirë TVSH-në. EYE shpreson që palët e interesuara të propozojnë një aktivitet, i cili do t'i përmbushë objektivat e kësaj KPP-je në mënyrë racionale.

### 5. Gjuha

Propozimi teknik dhe standardet e profesionit duhet të ofrohen në gjuhën shqipe.

### 6. Raportimi

Konsulentët e caktuar kryesorë do të jenë personat primar përgjegjës për raportim tek menaxherja e lartë e intervenimit në EYE që është përgjegjëse dhe do të bashkëpunojnë ngushtë me të. Gjatë periudhës kontraktuese, një përditësim i rregullt dyjavor duhet t'i dorëzohet EYE-it me shkrim përmes e-mailit.

*Prishtinë, më 5 nëntor, 2018*

<sup>1</sup> Nëse gjatë procesit të verifikimit AKK propozon përfshirjen e kërkesave shtesë në standardet e profesionit, konsulentët apo kompania e kontraktuar do të jetë e obliguar që t'i përmbushë këto kërkesa në kuadër të kësaj kontrate;